



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI

Nr. 162 Prot

Tiranë, më 28.01. 2020

VENDIM

Nr. 1, datë 28.01.2020

**"PËR
MIRATIMIN E FONDIT PËR BLERJEN E PAJISJEVE PARËSORE SPECIFIKE NË KUADËR TË
GJËNDJES SË KRIJUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Statutit të Universitetit Politeknik të Tiranës, me propozim të Administratorit të Institucionit, Senati në mbledhjen e datës 28.01.2020,

VENDOSI:

1. Të miratojë fondin për blerjen e pajisjeve parësore specifike, të kërkuara nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndertimit dhe Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, në kuader të gjëndjes së krijuar nga fatkeqesia natyrore, në vlerën totale 28.001,758 (njëzet e tetë milion e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë me TVSH;
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i Universitetit Politeknik të Tiranës;
3. T'i propozojnë Bordit të Administrimit miratimin e fondit sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof. Dr. **Andrea MALIQARI**

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

Adresa: Sheshi "Nene Tereza", Nr.4, Tirane,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al